

VENDIM
Nr. 20/2024

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR TRAJTIMIN E TË DHËNAVE TË SISTEMIT TIMS

(Ndryshuar me Vendimin nr. 56/2024, datë 12.6.2024)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 77, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 25 të rregullores së Kuvendit, me propozim të një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për Trajtimin e të Dhënave të Sistemit TIMS.

II. Komisioni Hetimor ka për objekt të veprimtarisë së tij:

i) shqyrtimin e çështjeve lidhur me kontrollin e veprimtarisë së institucioneve të ngarkuara me mbrojtjen e sistemit TIMS; dhe

ii) vlerësimin e nevojës për marrjen e masave administrative apo ndërhyrjet ligjore në legjislacionin përkatës në fuqi.

III. Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese, veçanërisht parimin e ndarjes së pushteteve, duke mos iu mbivendosur punës së organeve të drejtësisë, parimin për një proces të rregullt ligjor, parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e paanshmërisë dhe respektimit të jetës private të individit.

IV. Komisioni Hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime për marrjen e masave administrative dhe/ose ndryshime ligjore.

V. Komisioni Hetimor do të përbëhet nga 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë, nga të cilët kryetari dhe 6 (gjashtë) anëtarë propozohen nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike dhe 8 (tetë) anëtarë propozohen nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste si më poshtë:

1. Ervin Salianji	kryetar	PD
2. Toni Gogu	nënkryetar	PS
3. Nasip Naço	anëtar	PS
4. Blerina Gjylameti	anëtare	PS
5. Etilda Gjonaj	anëtare	PS
6. Xhemal Qefalia	anëtar	PS
7. Antoneta Dhima	anëtare	PS
8. Bardhyl Kollçaku	anëtar	PS
9. Denis Deliu	anëtar	PS
10. Lindita Metaliaj	anëtare	PD
11. Lefter Gështenja	anëtar	PD
12. Asllan Dogjani	anëtar	PD
13. Ramadan Likaj	anëtar	PD
14. Luan Baçi	anëtar	PD
15. Elda Hoti	anëtare	PD

Anëtarët zëvendësues:

1. Eduart Nreca	anëtar zëvendësues	PS
2. Laer Duraj	anëtar zëvendësues	PS
3. Bledion Nallbati	anëtar zëvendësues	PD

- | | | |
|-------------------------------|--------------------|----|
| 4. Klevis Xhoxhi ¹ | anëtar zëvendësues | PS |
| 5. Bujar Çela | anëtar zëvendësues | PS |
| 6. Pranvera Resulaj | anëtar zëvendësues | PS |

VI. Komisioni Hetimor do të zhvillojë veprimtarinë e tij në një afat kohor 4-mujor nga data e miratimit të këtij vendimi. Në rast nevojë, me kërkesë të arsyetuar të Komisionit, Kuvendi vendos zgjatjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së komisionit.

VII. Ngarkohen Kryetari i Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm për krijimin e kushteve të punës dhe mbështetjen logjistike të veprimtarisë së këtij Komisioni Hetimor.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 21.3.2024.

¹ Vendimi nr. 56/2024, datë 12.6.2024 botuar në F.Z nr.105, datë 26.6.2024 në pikën 1 të tij është shprehur: “Në pikën V të vendimit nr. 20/2024, “Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për Trajtimin e të Dhënave të Sistemit TIMS”, bëhet shtesa si më poshtë:

Anëtarë zëvendësues:

- | | |
|---------------------|-----|
| 1. Klevis Xhoxhi | PS |
| 2. Bujar Çela | PS |
| 3. Pranvera Resulaj | PS” |